



Nëse ka ndodhur një aksident i rëndë!

Informacionet kryesore në një përmbledhje.

Albanische Fassung

Të dhënat për kontakt / Kontaktdaten

Numri i lëndës / Ihr Aktenzeichen

Referenti/ referentja juaj / Ihre Sachbearbeiterin,
Ihr Sachbearbeiter

Numri i telefonit / Telefonnummer

Adresa e-mail / E-Mail-Adresse



Të dashura lexuese, të dashur lexues,

Keni përjetuar një aksident të rëndë i cili për ju dhe familjen tuaj hap pyetje të shumta dhe ju vendos para sfidave të reja. Në rast se bëhet fjalë për një aksident pune, te BG BAU (Berufsgenossenschaft der Bauwirtschaft) jeni në duart më të mira. Ne jemi sigurimi juaj ligjor ndaj aksidenteve dhe duam që ju sa më parë të shëroheni.

Ne do të kujdesemi me të gjitha mjetet e përshtatshme për mjekimin tuaj dhe kthimin me sukses në punë. Ne po ashtu do t'ju ofrojmë të gjitha shërbimet të cilat ju takojnë.

Me këtë broshurë duam t'ju japim orientimin lidhur me ecurinë e mëtejme të mjekimit dhe t'ju përgjigjemi në pyetjet më të rëndësishme. Këto informacione plotësojnë kontaktin tuaj personal me personat kontaktues pranë BG BAU. Mos hezitoni të kontaktoni direkt me ne.

Jemi në anën tuaj dhe ju dëshirojmë shërim të shpejtë.

BG BAU e juaj



Informacionet më të rëndësishme nga A deri Z

Faqe 8 – Personat kontaktues pranë BG BAU

- Kush ose çka është BG BAU?
- Kush më përkeqëson në rrugën time të kthimit në botën e punës pas aksidentit në punë?

Faqe 10 – Aksidenti në punë

- Në cilat raste aksidenti mund të quhet aksident në punë?

Faqe 10 – Dëshmia e paaftësisë për punë (AU-Bescheinigung, Pushimi mjekësor)

- Ku mund të marr një AU-Bescheinigung dhe çka mund të bëj me të?

Faqe 11 – Procesi i mjekimit në kuadër të sigurimit ndaj aksidenteve në punë:

- Çka do të thotë mjekim në kuadër të sigurimit shëndetësor (berufsgenossenschaftliche Heilverfahren)?
- Si dhe ku do të trajtohem?
- A mund të kërkoj shërbimet e mjekut/ mjekes familjare për trajtim të mëtejshëm pas lëshimit nga spitali?
- A duhet të bëj pagesa shtesë për medikamente, mjete ndihmëse ose terapi?
- Fiziooterapia e zgjeruar ambulatorie (EAP)

Faqe 13 – Shërbimet në para

- A do të marr pas aksidentit në punë edhe më tej rrogën time?
- Çka nënkuptojmë me para të lëndimit?
- Sa është lartësia e parave të lëndimit?
- Kush dhe kur paguan paratë të lëndimit?
- Çka ndodh me kontributet e sigurimit social për Sigurim Shëndetësor dhe Sigurim të Përkujdesjes?
- Jam duke punuar me orar të shkurtuar dhe/ ose marr përfitime nga agjencia e punësimit.
Në çka duhet të kem kujdes?
- Jam i vetëpunësuar. Cilat janë të veçantat në këtë rast?
- Kush merr përsipër shpenzimet e mia të udhëtimit dhe transportit dhe sie mund t'i paraqesato?
- Kush i paguan rrobat e mia të shkatërruara të punës?
- Çka ndodh me syzat e mia të dëmtuara, me protezat etj.?

Faqe 17 – Të jesh prapë në qendër të jetës: në jetën profesionale dhe sociale

- Si mund të kthehem në vendin tim të punës?
- Çka ndodh nëse nuk mund të kthehem më në vendin tim të punës?
- Si ndihmon BG BAU gjatë kthimit të mjedisin tim social?



**Për shërbimet
tona vlen:
Të gjitha
në një vend.**


Disa filma të shkurtë shpjegojnë punën dhe shërbimet tona

Nëse keni telefon të mençur në të cilin keni të instaluar një skaner të kodeve QR, mund ta skanoni kodin QR të paraqitur tek disa nga temat e caktuara. Më pas do t'ju hapet një faqe interneti dhe aty do të gjeni filmat përkatës.

- Sigurimi juaj ligjor ndaj aksidenteve
- Reha-Management (Menaxhimi i rehabilitimit)
- Koordinatorët dhe koordinatorët Reha
- Aksidenti në punë - çka është ai?

Disa nga QR-Kodet ju qojnë po ashtu te informacionet më të detajuara në faqet e internetit të BG BAU.

Titrat e videos mund të ndryshohen në gjuhë të tjera. Një udhëzim për këtë e gjeni këtu.



Personat kontaktues pranë BG BAU

Kush ose çka është BG BAU?

Keni pësuar aksident gjatë punës, gjatë shkuarjes në punë ose kthimit nga puna? Në rast se kemi të bëjmë me aksident në punë do të vjen në shprehje Sigurimi ligjor ndaj Aksidenteve. Si e punësuar ose i punësuar, përmes punëdhënësës ose punëdhënësit tuaj ju jeni i siguar nga pasojat e aksidenteve në punë, ose si ndërmarrëse/ndërmarrës jeni siguar tek ne në mënyrë vullnetare.

BG BAU është sigurim ligjor ndaj aksidenteve për sektorin e ndërtimitarisë ose shërbimet e lidhura me sektorin e ndërtimitarisë dhe janë pjesë përbërëse e sigurimeve ligjore shëndetësore (gewerbliche Berufsgenossenschaften) në Republikën Federale Gjermane.



Më shumë informacione do të gjeni në këtë film:

Sigurimi juaj ligjor ndaj aksidenteve
www.bgbau.de/erklaerfilm-gesetzliche-uv



Kush më përkrah në rrugën time të kthimit në botën e punës dhe jetën e përditshme pas aksidentit në punë?

Gjatë gjithë kohës së shërimit tuaj do të keni përkujdesjen e kolegeve dhe kolegëve nga Reha-Management. Ata janë menaxheret dhe menaxherët e Reha, koordinatore dhe koordinatorët e Reha sie dhe zyrtaret dhe zyrtarët specialistë për trajtim të aksidenteve të cilat kryejnë për ju detyra nga më të ndryshmet.

Menaxheret dhe menaxherët Reha

Menaxherja Reha ose menaxheri Reha nga BG-ja jonë është personi i juaj kryesor kontaktues gjatë gjithë procesit të shërimit dhe do të vendosin kontaktin me ju sa më shpejtë që të jetë e mundur.

Menaxheret Reha dhe menaxheri Reha, përveç tjerash i kanë edhe këto detyra të rëndësishme:

- Ata koordinojnë dhe drejtojnë procesin e shërimit me të gjithë pjesëmarrësit. Kjo do të thotë se ata janë personat qendror kontaktues për ju dhe familjarët tuaj, për mjeket dhe mjekët, terapeutet dhe terapeutët, punëdhënëset dhe punëdhënësit si dhe kolege dhe kolegë të BG BAU në lokacione të ndryshme.
- Ata do të kujdesen që të gjitha masat e veçanta të Reha të ndërlihen në mënyrë optimale me njëra tjetrën.
- Ata përkujdesen që ju të mund sërish të punoni sa më shpejt të jetë e mundur. Qëllim prioritar është që ju të ruani vendin tuaj të mëparshëm të punës dhe të mund të rinisni përsëri punën tuaj profesionale. Vetëm nëse një gjë e tillë nuk është e mundur do të kërkohen bashkë me ju mundësi të tjera pune ose profesione.

Më shumë informacione do të gjeni në këtë film:

Reha-Management
www.bgbau.de/erklaerfilm-reha-management





Për të pasur sa më parë një „plan veprimi“ për trajtimin e mëtejshëm mjekësor, Menaxherja Reha ose Menaxheri Reha do të përpilojë në kohën e duhur dhe bashkë me ju dhe me mjeket dhe mjekët trajtues një plan individual rehabilitimi.

Në këtë plan do të shënohen të gjitha masat tjera dhe objektivat. Në kuadër të trajtimit shërues do të verifikohen vazhdimisht hapat e veçantë të planit Reha dhe të përshtatën ose vazhdojnë në rast nevojë.

Koordinatorët dhe koordinatorët Reha

Si shërbim i veçantë të BG BAU është prania e koordinatorëve dhe koordinatorëve Reha në të gjitha klinikat e BG. Ata kanë vendet e tyre të punës direkt nëpër klinika dhe janë personat tuaj personal kontaktues gjatë trajtimit stacionar.

Kjo vlen gjatë kohës së trajtimit akut dhe gjatë trajtimeve të mëvonshme në klinikën BG. Koordinatorët dhe koordinatorët Reha ju përkrahin juve dhe familjarët tuaj. Ata ndodhen në kontakt të afërt me mjeket dhe mjekët si dhe terapeutet dhe terapeutët në klinikë për të qartësuar çështjet dhe problemet direkt dhe sa me shpejt.

Më shumë informacione do të gjeni në këtë film:

Reha-Koordinatorinnen und Reha-Koordinatoren
www.bgbau.de/erklairfilm-reha-koordinatoren



Zyrtaret dhe zyrtarët për trajtimin e aksidenteve

Përveç kolegeve dhe kolegëve në koordinim të rehabilitimit (Reha) dhe menaxhimin e Reha, në dispozicionin tuaj janë zyrtari ose zyrtarja e juaj personal e aksidenteve për t'u përgjigjur pyetjeve tuaja dhe për të dhënë informacione të mëtejshme.

Ata do t'u përgjigjen të gjitha pyetjeve në lidhje me aksidentin dhe rehabilitimin tuaj. Ata kontrollojnë dhe ju japin përfitimet financiare të cilat ju takojnë. Për më tepër, ata planifikojnë ri-integrimin tuaj në jetën e punës në koordinim të ngushtë me menaxherin ose menaxheren e Reha.



Aksidenti në punë

Në cilat raste aksidenti mund të quhet aksident në punë?

Aksidentet në punë janë aksidentet që pësojnë personat e siguruar për shkak të punës së siguruar të cilat mund të kenë për pasojë dëmtimin e shëndetit ose vdekjen. Aty bëjnë pjesë edhe aksidenti i cili ndodh gjatë rrugës së drejtpërdrejtë për punë ose rrugës për në shtëpi.

Përkundër të gjitha përpjekjeve për parandalim, aksidentet e punës nuk mund të evitohen çdo herë.

Në rast të aksidentit të punës ne drejtojmë dhe koordinojmë trajtimin shërues dhe kujdesemi për trajtimin më të mirë mjekësor. Ne ju përkrahim në ri-integrimin profesional dhe jetën sociale.

Më shumë informacione do të gjeni në këtë film:

Aksidenti në punë - çka është ai?

www.bgbau.de/erklaerfilm-arbeitsunfall



Dëshmia e paaftësisë për punë (AU-Bescheinigung, Pushimi mjekësor)



Ku mund ta marr një raport mjekësor për paaftësi për punë dhe çfarë duhet të bëj me të?

Raporti mjekësor për paaftësi për punë, që nga janari i vitit 2023, zakonisht dërgohet në mënyrë elektronike nga ordianca te sigurimi shëndetësor. Punëdhënësi i merr të dhënat më pas drejtpërdrejt nga sigurimi shëndetësor. Paraqitja e raportit në format letre te punëdhënësi zakonisht nuk është më e nevojshme.

Udhëzim për personat me sigurim privat:

Personat me sigurim privat vazhdojnë të marrin një vërtetim paaftësie për punë në formë letre. Këto duhet t'i dërgoni vetë, si më parë, te punëdhënësi juaj. Një kopje tjetër duhet ta dërgoni te BG BAU.

Procesi i mjekimit në kuadër të sigurimit ndaj aksidenteve në punë (Berufsgenossenschaftliches Heilverfahren)

Çka do të thotë mjekim në kuadër të sigurimit shëndetësor (berufsgenossenschaftliche Heilverfahren)?

Rehabilitimi para pensionit - është parimi themelor sipas të cilit veprojnë të gjithë bartësit e sigurimit ndaj aksidenteve. Kjo do të thotë se ne, në radhë të parë kujdesemi që ju të keni një shërbim optimal mjekësor. Qëllim prioritar është që ju të ktheheni vendin tuaj të të punës dhe të mund të rinisni përsëri punën tuaj profesionale. Këtë e bëjmë me angazhim personal dhe të gjitha mjetet e përshtatshme që i kemi në dispozicion.

Si dhe ku do të trajtohem?

Trajtimi akut stacionar

Së pari bëhet trajtimi optimal i lëndimit tuaj. Sipas llojit dhe peshës së lëndimit tuaj, trajtimi në raste të caktuara bëhet vetëm në spitalet e specializuara të trajtimit emergjent.

Këto klinika duhet të plotësojnë kërkesa speciale në lidhje me personelin, hapësirën dhe kushteve teknike.

Rehabilitimi kompleks stacionar (KSR)

KSR është mënyrë e veçantë e trajtimit stacionar. Ai bëhet vetëm në klinikat e BG. KSR vjen në shprehje nëse ju keni nevojë për rehabilitim intensiv terapeutik, kur keni nevojë të shtuar të përkujdesjes, ose ekziston nevojë e shtuar për përkujdesje mjekësore. Në mbarë Gjermaninë janë nëntë klinika të BG: Halle Duisburg-Buchholz, Frankfurt/Main, Ludwigshafen, Murnau, Tübingen, Hamburg, Bochum dhe Berlin-Marzahn.

Trajtimi i mëtejshëm stacionar në kuadër të bartësit të sigurimit shëndetësor ndaj aksidenteve (BGSW Berufsgenossenschaftliche stationäre Weiterbehandlung)

BGSW ofron mundësi të shtuara të rehabilitimit në rast të lëndimit të aparatit muskulo-skeletor. Ai fillon sapo të jeni në gjendje të ngarkoni trupin mjaftueshëm dhe është i mundur realizimi i një trajtimi intensiv.

Kjo masë stacionare e rehabilitimit kryhet nën mbikëqyrje mjekësore dhe përmes kombinimit të terapive të shumëllojshme fizikale, kontribuon në suksesin e mjekimit.

Për këtë lloj të procesit shërues janë të lejuara vetëm disa klinika rehabilitimi me kualifikime të veçanta, të cilat kanë pajisje dhe personel të përshtatshëm.





Trajtimi ambulant

A mund të kërkoj shërbimet e mjekut/ mjekes familjare për trajtim të mëtejshëm pas lëshimit nga spitali?

Për fat të keq, një gjë e tillë nuk është e mundur. Për trajtim të mëtejshëm ambulant keni në dispozicion një të ashtuquajtur mjek tranzit (Durchgangsarzt) ose mjekë tranzite (D-Ärzte).

Mjeket dhe mjekët tranzit janë specializuar për drejtimet kirurgji me specializim në kirurgjinë e traumës ose për drejtimet ortopedi dhe kirurgji e traumës. Ne ju përkrahim me kënaqësi gjatë kërkimit tuaj për D-Ärztin ose D-Arzt në afërsi të vendbanimit tuaj.

Në internet keni në dispozicion edhe një kërkim online:
www.bgbau.de/d-arzt-suche

Fizioterapja e zgjeruar ambulatorë (EAP)

EAP janë masa gjithëpërfshirëse të rehabilitimit ambulator. Në këto raste përdoren kombinime terapish standarde si terapia lëvizëse, fizioterapia, masazhet dhe elektroterapia.

Këto terapi plotësohen me terapi të trajnimit mjekësor. Përmes trajnimit me vegla përmirësoni forcën, qëndrueshmërinë dhe koordinimin dhe kështu rritni lëvizshmërinë dhe performancën.

Bashkëveprimi i njësive individuale të terapisë bazohet gjithmonë në rastin individual dhe monitorohet rregullisht nga mjeku.

Terapia EAP do të udhëzohet në rastet kur përmes terapive standarde të veçanta nuk arrihet ose vonohet qëllimi i rehabilitimit.

A duhet të bëj pagesa shtesë për medikamente, mjete ndihmëse ose terapi?

Në parim jo! Nëse keni një aksident në punë, ne do të mbulojmë shpenzimet e trajtimit tuaj mjekësor. Kjo vlen edhe për të gjitha pajisjet mjekësore dhe mjetet ndihmëse të përshkruara dhe medikamentet, nëse çmimet e tyre të jenë të caktuara sipas sigurimit ligjor shëndetësor.

Prandaj, ligjvënësi parashikon që kostot e barnave të përshkruara duhet të rimburohen vetëm deri në shumën e caktuar nëse qëllimi i trajtimit mjekësor mund të arrihet me barëra dhe mjete lidhëse për të cilat janë përcaktuar shuma fikse.

Shërbimet në para

A do të marr pas aksidentit në punë edhe më tej rrogën time?

Në rast se për shkak të aksidentit në punë nuk jeni në gjendje të punoni, dhe ju jeni i punësuar me shumë se katër javë në kompani, punëdhënësja ose punëdhënësi parimisht do t'ju paguajë për gjashtë javë pagën tuaj.

Çka nënkuptojmë me para të lëndimit?

Pas përfundimit të periudhës gjatë të cilës jeni kompensuar, keni të drejtë në para të lëndimit si një lloj kompensim rezervë. Paratë e lëndimit i merrni nga ne, BG BAU gjatë kohës që nuk jeni në gjendje të punoni si shkak i aksidentit.

Sa është lartësia e parave të lëndimit?

Shuma e parave të lëndimit është 80% e pagës tuaj të rregullt bruto. Kjo pagë nuk mund të kalojë lartësinë e pagës së fundit neto. Për shkak të pagimit të kontributeve për sigurim social dhe sigurim pensional nga paratë e lëndimit, shuma e parave të lëndimit mund të mbetet më e vogël se paga juaj e fundit neto.

Parimisht llogaritet duke u nisur nga të ardhurat mujore e përlllogaritur para ndodhjes së aksidentit. Orët shtesë mund të merren parasysh nëse janë realizuar rregullisht gjatë 3 muajve të fundit para aksidentit.

Kush dhe kur paguan paratë e lëndimit?

Pagesën e kompensimit për të lënduarit zakonisht e kryen, me autorizimin tonë, sigurimi juaj shëndetësor.

Paratë e lëndimit nuk duhet përzier me kompensimin gjatë sëmundjes, të cilat i paguajnë sigurimet shëndetësore në rast të sëmundjeve.

Parimisht vlen se paratë e lëndimit duhet të paguhet sa më parë. Ne, BG BAU për fat të keq nuk kemi ndikim në kohën kur Sigurimi juaj Shëndetësor do të paguajë paratë e lëndimit. Kjo varet nga kushtet e pagesës së Sigurimit tuaj Shëndetësor. Nëse keni pyetje rreth pagesës duhet të drejtoheni direkt te Sigurimi juaj Shëndetësor.





Çka ndodh me kontributet e sigurimit social për Sigurim Shëndetësor dhe Sigurim të Përkujdesjes?

Kontributet e sigurimit Shëndetësor dhe të përkujdesjes dhe të merren plotësisht përsipër nga ne.

Jam duke punuar me orar të shkurtuar dhe/ ose marr përfitime nga agjencia e punësimit. Në çka duhet të kem kujdes?

Fatkeqësisht, ne nuk mund të vërejmë qartë nga të dokumentet mjekësore ose të dhënat nga punëdhënësjë ose punëdhënësi juaj se ju jeni i punësuar me orar të shkurtër pune, ose se ju keni disa punësime me orar të shkurtër pune.

Sapo të jemi informuar, ne do të llogarisim paratë e lëndimit duke u bazuar në punësimin(et) me orar të shkurtër dhe do të udhëzojmë Sigurimin tuaj Shëndetësor t'ju bëjë pagesën. Nëse merrni përfitime nga agjencia e punësimit, ju lutemi na njoftoni gjithashtu.

Ju lusim të na njoftoni sa më shpejt në mënyrë që të mos ketë vonesa në ofrimin e shërbimeve tona. Ju lusim të kontaktoni menaxherin ose menaxheren tuaj të Reha ose thirrni zyrtaren ose zyrtarin tuaj përgjegjës.

Jam i vetëpunësuar. Cilat janë të veçantat në këtë rast?

Si ndërmarrëse ose ndërmarrës, ju jeni i siguruar pranë nesh në mënyrë vullnetare. Në këtë mënyrë, edhe ju keni të drejtë në para të lëndimit. Sidoqoftë, për shkak të faktorëve të ndryshëm, do të kemi shuma dhe periudha të ndryshme të pagesës.

Për ti kalkuluar në mënyrë korrekte pretendimet tuaja, ju lusim të na kontaktoni sa më shpejt. Sapo të jenë njohur dhe marrë parasysh të gjithë faktorët, do të fillojë pagesa e parave të lëndimit nga ana e Sigurimit tuaj Shëndetësor në rast se jeni vullnetarisht i siguruar.

Në rast se jeni siguruar te institucioni privat, si parim, pagesën e parave të lëndimit në emrin tonë e kryen AOK-ja.

Kush merr përsipër shpenzimet e mia të udhëtimit dhe transportit dhe si mund ti paraqes ato?

Ne gjithashtu ju rimbursojmë shpenzimet e udhëtimit dhe transportit që mund të lindin, p.sh. për trajtimin mjekësor të organizuar nga sigurimi profesional për punonjësit. Rimbursimin e shpenzimeve mund ta kërkontë në mënyrë dixhitale përmes portalit tonë:
[meine BG BAU/Schnell & einfach online antworten/](#)
[Formulare/Fahrtkosten.](#)

Ose mund t'i dërgoni dokumentet dhe dëshmitë pa ndonjë format të caktuar, me postë. Ju lutemi, jepni patjetër detajet e llogarisë tuaj bankare.

Dëshmia e terminëve për trajtim

Për t'ju rimbursuar shpejt shpenzimet e udhëtimit dhe transportit, neve na nevojitet gjithmonë konfirmimet e mjekeve dhe mjekëve resp. e terapistëve dhe terapistëve rreth pjesëmarrjes tuaj në terminët e akorduara për trajtime.



Mjetet e transportit publik

Ne ju rimbursojmë të gjitha vozitjet me mjete të transportit publik si tren, autobus, tramvaj, U-Bahn, S-Bahn ose ngjashëm.

Ju lusim ti ruani biletat dhe dëshmitë dhe dorëzoni ato në original tek ne bashkë me përllogaritjen tuaj.

Ju lus të keni parasysh se duhet t'i shfrytëzoni të gjitha lirimet e çmimeve të biletave.

Veturat dhe pagesa e parkingut

Në rast të vozitjes me veturë private ne ju rimbursojmë paushallin për kilometër në lartësi prej 0,20EUR/km deri në një shumë maksimale prej 130 EUR.

Ju lus të shënoni kilometrat e kaluar gjatë kur bëni përllogaritjen. Edhe taksa e parkingut do të rimbursohet. Ju lusim të dorëzoni faturat origjinale.


Taxi, personi shoqërues, transporti i të sëmurit

Në rastet e kufizimeve tejet të rënda, ne mbulojmë edhe shpenzimet e udhëtimeve me taksë, të një shoqëruesi ose të transportit të sëmurit..

I Në këto raste, mjekët vendosin për mjetet e nevojshme të transportit dhe nëse është e domosdoshme të keni një person shoqërues. Në këto raste, ata lëshojnë një udhëzim mjekësor para fillimit të udhëtimit.

Më shumë informacione do të gjeni në këtë film:

<https://online-antwort.meine.bgbau.de/formular-online-ausfuellen>



Udhëtimet te familja

Nëse për shkak të masave shëruese sipas sigurimit ndaj aksidentit jeni akomoduar jashtë vendbanimit tuaj, ne marrim përsipër shpenzimet e udhëtimit te vendbanimi juaj në këtë vëllim::

1. Në kuadër të trajtimit stacionar:

- Një udhëtim te vendbanimi juaj nëse jeni më pak se katër por më shumë se dy javë në trajtim stacionar.
- Dy udhëtime në muaj nëse jeni më shumë se katër javë në trajtim stacionar.

2. Në kuadër të rehabilitimit stacionar:

- Një udhëtim në shtëpi për herë të parë pas tetë javësh, nëse masa e rehabilitimit pritet të zgjasë të paktën edhe dy javë më gjatë.
- Udhëtime tjera në shtëpi deri në gjithsej dy udhëtime në muaj, në secilin rast pas afatit prej dy javësh, me kusht që të ketë mbetur një periudhë prej të paktën dy javësh e marrjes së shërbimeve rehabilituese.


Kush i paguan rrobat e mia të shkatërruara të punës?

Ne marrim përsipër koston e dëmtimit të shëndetit. Kostot e mallrave për rroba ose gjëra tjera të shkatërruara si p.sh. smartphone nuk mund t'i marrim përsipër.

Çka ndodh me syzat e mia të dëmtuara, me protezat etj.?

Për dallim nga rrobat ose gjërat tjera me vlerë, mjetet ndihmëse për shikim (p.sh. syza, lente kontakti etj.) ose "elemente zëvendësuese të trupit" (p.sh. proteza dhëmbësh) janë pjesë e trupit tuaj. Në rast se ato janë dëmtuar gjatë aksidentit në punë ne mund ti marrim përsipër kostot për to. Ju lusim të flisni për këto gjëra me referentën/ referentin tuaj ose kolegen dhe kolegun nga menaxhmenti i Reha.

Si alternativë e udhëtimeve tuaja në shtëpi dhe në pajtim me parakushtet e cekura më sipër, ne marrim përsipër edhe kostot e udhëtimeve për vizita të familjarëve tuaj deri në vendqëndrimin tuaj, duke u nisur nga vendbanimi i përbashkët.



Të jesh prapë në qendër të jetës: në jetën profesionale dhe sociale

Si mund të kthehem në vendin tim të punës?

Detyra dhe qëllimi ynë është t'ju mundësojmë të ktheheni në vendin e mëhershëm të punës. Për këtë qëllim, ne përdorim të gjitha mjetet e duhura dhe shqyrtojmë masat e nevojshme së bashku me ju dhe punëdhënësin/ punëdhënësen tuaj. Këto mund të përfshijnë shërbime shtesë rehabilitimi ose shërbime tjera për t'ju ndihmuar të mbani vendin tuaj të punës.

Këto përfshijnë p.sh. ri-integrimin gradual (i ashtuq. testimi në punë dhe shkallës së ngarkesës), ri-dizajnimi i vendit tuaj të punës, përdorimi i mjeteve ndihmëse ose asistencë në punë.

Nëse kthimi në punën tuaj të mëparshme nuk është i mundur, ne të paktën do të përpiqemi të ruajmë punësimin tuaj në kompaninë tuaj aktuale. Masat e mundshme janë p.sh. kualifikime të reja ose të mëtejshme dhe transferim në një vend tjetër pune.

Çka ndodh nëse nuk mund të kthehem më në vendin tim të punës?

Nëse për shkak të pasojave të aksidentit nuk mund të ktheheni në profesionin e ushtruar në momentin e aksidentit, ne do t'ju përkrahim në riorientimin tuaj profesional.





Si ndihmon BG BAU gjatë kthimit të mjedisin tim social?

Fatkeqësisht, rehabilitimi i plotë nuk është gjithmonë i mundur. Pas përfundimit të trajtimit, mund të mbeten kufizime të përhershme. Ndoshta nuk do të jeni në gjendje të merrni pjesë në jetën sociale si më parë ose mund ta bëni këtë vetëm me përpjekje të mëdha.

Nëse e keni të pamundur të përballoni si i vetëm kërkesat e jetës së përditshme pa ndihmën e duhur, BG BAU do t'ju ofrojë përfitime në mënyrë që të mund të vazhdoni të jetoni në komunitet dhe me komunitetin.

Këto mund të jenë, për shembull, punët e nevojshme të rinovimit në banesën, shtëpinë ose automjetin tuaj. Përveç kësaj, mund t'ju vëmë në dispozicion mjete të ndryshme ndihmëse për t'ju lehtësuar jetën e përditshme.

Impressum

Të dhënat e botuesit

BG BAU - Berufsgenossenschaft der Bauwirtschaft
Bundesallee 210
10719 Berlin

Telefoni: 0800 3799100
Faksi: 0800 6686688-37310
E-Mail: rrl@bgbau.de
www.bgbau.de

Botimi

Gusht 2025

Shtypshkronja

LM Druck + Medien GmbH
Obere Hommeswiese 16, 57258 Freudenberg

Të drejtat e autorit

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Shtypja, riprodhimi dhe shpërndarja e materialit – edhe pjesërisht – lejohet vetëm me miratimin e BG BAU.

Burimet e fotografive:

Fotografia e kopertinës: kzenon/Getty Images

Faqe 3: Chinnapong/Fotolia

Faqe 4: Jan Pauls Fotografie, Joshua A. Hoffmann, PR-Fotografie Köhring

Faqe 6: oatawa/Fotolia.de

Faqe 7: Jan Pauls Fotografie

Faqe 8: Jan Pauls Fotografie

Faqe 9: Jan Pauls Fotografie, PR-Fotografie Köhring

Faqe 10: Stockfotos-MG/Fotolia

Faqe 11: BG BAU, Joshua A. Hoffmann

Faqe 12: Photographee.eu/Fotolia

Faqe 13: arahan/Fotolia

Faqe 14: euregiophoto/Fotolia

Faqe 15: horstgerlach/Getty Images

Faqe 16: enigma_images/Getty Images

Faqe 17: Bruno Streitmatter/BG BAU

Faqe 18: Jan Pauls Fotografie

BG BAU
Berufsgenossenschaft der Bauwirtschaft

Bundesallee 210
10719 Berlin
Telefoni: 0800 3799100
Telefaksi: 0800 6686688-37310
Emaili: rrl@bgbau.de



 www.bgbau.de

